



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## RAPORT MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit vendas me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe për t'i ofruar një mbrojtje juridike sa më efektive viktimave të diskriminimit, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (LMD). Një kontribut të rëndësishëm në veprimtarinë për lobimin, në hartimin dhe miratimin e këtij ligji dhanë përfaqësuesit e shoqërisë civile në Shqipëri, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe përfaqësuesit e trupës diplomatike të akredituar në Shqipëri. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ishte një ndër organizatat jo fitimprurëse që ofroi ekspertizë ligjore gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të këtij ligji.

Ky ligj solli një sërë risish në legjislacionin shqiptar, duke parashikuar garanci ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi për të gjithë personat që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për të gjithë ata shtetas shqiptarë dhe të huaj, që jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë, në raport me organet shtetërore shqiptare. Një ndër garancitë ligjore më të rëndësishme që ligji parashikon, është krijimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD). KMD është një institucion publik i pavarur dhe i specializuar, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Bazuar në nenin 21 të LMD, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet vendimit nr. 33, datë 22.04.2010, zgjodhi zonjën Irma Baraku në detyrën e Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe nëpërmjet vendimit nr. 34, datë 20.05.2010, Kuvendi miratoi strukturën, organikën dhe kategorizimin e pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke mundësuar fillimin e funksionimit të këtij institucioni. KShH, në kuadër të mbikëqyrjes qytetare të veprimtarisë së administratës publike, me mbështetjen e CRD, monitoroi veprimtarinë e KMD dhe në përfundim përgatiti këtë raport.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të analizojë veprimtarinë e KMD-së, nga koha kur institucioni filloi të funksionojë e deri në fund të vitit 2011, si dhe të ofrojë rekomandime konkrete, të cilat synojnë përmirësimin e punës së këtij institucioni në të ardhmen. Analiza e veprimtarisë së KMD është bërë në dritën e kompetencave të rëndësishme që i akordohen atij nga Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Gjithashtu, ky raport synon të evidentojë edhe problemet ligjore që janë konstatuar nga praktika e zbatimit të ligjit.

Metodologjia që u përdor për mbledhjen e informacionit ka qenë realizimi i takimeve me znj. Irma Baraku dhe stafin e KMD-së, shqyrtimi i legjislacionit në këtë fushë, analiza e informacionit të pasqyruar në Draftin e Planit Strategjik dhe Planin e Veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi 2012 – 2015<sup>1</sup>; vlerësimi i punës së deritanishme të KMD-së. Në këtë raport është përfshirë dhe problematika, që KShH ka evidentuar gjatë zbatimit të projekteve të ndryshme, lidhur me situatën e diskriminimit në vend, ngritjen e kapaciteteve të KMD-së dhe OJF-ve lokale që punojnë në fushën e të

---

<sup>1</sup> Përgatitur nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, OSFA



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

drejtave të njeriut, sensibilizimin e komunitetit lokal në rrethe të ndryshme për LMD si dhe asistimin e KMD-së në hartimin e akteve të brendshme të zyrës. Në vijim të raportit janë pasqyruar konkluzionet dhe rekomandimet tona.

## 1. Burimet financiare

KMD është një institucion i pavarur dhe si i tillë përgatit dhe mbron vetë projektbuxhetet për vitet në vazhdim, duke mbajtur parasysh nevojat që lidhen me zbatimin e detyrave që ky institucion duhet të kryejë sipas ligjit. Me fonde të Buxhetit të Shtetit të vitit 2011 u bë e mundur ristrukturimi i mjediseve që ju vunë në dispozicion KMD. Në këtë kuadër veç vlerësimit pozitiv për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune për këtë institucion, meriton të nënvizohet edhe mundësimi i një ambienti, pranë institucionit, për zhvillimin e trajnimeve të stafit. Megjithatë, buxheti i miratuar nga Kuvendi për veprimtarinë e KMD-së për vitin 2012 nuk është i mjaftueshëm për sigurimin e pajisjeve të nevojshme kompjuterike, përmirësimin e infrastrukturës si dhe për realizimin e aktiviteteve me karakter sensibilizues dhe ndërgjegjësues. Në këtë buxhet nuk është parashikuar fond për hapjen e zyrave lokale të KMD-së në rrethe, siç parashikohet në ligj.

## 2. Ngritja e kapaciteteve institucionale të KMD-së dhe publiciteti

Përveç punës së kryer nga vetë institucioni, stafi i zyrës së KMD-së ka marrë pjesë në disa trajnime dhe tryeza pune, të cilat kanë patur si synim ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile, nëpërmjet trajtimit të tematikave të ndryshme për çështjet e diskriminimit. Këto trajnime janë organizuar nga organizata të vendit dhe ndërkombëtare si: Komiteti Shqiptar i Helsinkit<sup>2</sup>, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur Shqipëri (OSFA), Pink Embassy, UN Volunteers dhe Young European Federalists, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës etj. Gjithashtu stafi ka marrë pjesë edhe në disa vizita studimore dhe vizita pune të zhvilluara në Suedi, Britaninë e Madhe, Hollandë etj, shtete të cilat kanë praktikë të konsoliduar për ndjekjen dhe trajtimin e çështjeve të diskriminimit.

Stafi i KMD-së vlerëson si të rëndësishëm vazhdueshmërinë e ngritjes së kapaciteteve të tij në të ardhmen, veçanërisht për sa i takon tematikave të tilla si: procedurat për hetimin e çështjeve të diskriminimit, procedurat e ankimimit të personit/grupit të personave në subjektet private, konsolidimi i marrëdhënieve të KMD-së me publikun, çështjet e diskriminimit për personat me aftësi të kufizuar, romët, etj.

Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë – Soros (OSFA)<sup>3</sup> ka hartuar dhe është në procesin e finalizimit të Planin Strategjik dhe Planit të Veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitet 2012-2015. Në procesin e hartimit të këtij plani, OSFA përfshiu përfaqësues të shoqërisë civile, aktivë në këtë fushë, në vijim të një procesi konsultues me të gjitha institucionet publike me kompetenca në fushën e antidiskriminimit. Kjo strategji përbën një instrument të rëndësishëm për KMD dhe për të gjithë aktorët e tjerë publikë dhe jopublikë, që janë të përfshirë në çështjet e diskriminimit, për një kuptim të përbashkët të situatës së mosdiskriminimit, sfidave në këtë drejtim dhe përbalimin e tyre.

<sup>2</sup> Këto trajnime janë kryer në kuadër të mbështetjes financiare të KShH nga Civil Rights Defenders

<sup>3</sup> Nëpërmjet Programit të Shtetit të së Drejtës dhe të Drejtat e Njeriut, në Fondacionin Soros



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

KMD në bashkëpunim me zyrën e OSBE-së në Shqipëri po finalizon përgatitjen e faqes së internetit të institucionit. Gjithashtu, zyra e OSBE-së në Shqipëri po punon për përgatitjen e një komentari që do të mundësojë zbatimin më të mirë të LMD. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me mbështetjen financiare të Civil Rights Defenders dhe Ambasadës Hollandeze në Shqipëri, ka asistuar KMD-në në përgatitjen e disa nga akteve të brendshme të zyrës si : formulari i ankesës, regjistrat e të dhënave të ankuesve, etj.

### 3. Masat pozitive

LMD përcakton institucionet përgjegjëse për marrjen e masave pozitive, të cilat janë masa të përkohshme dhe të veçanta, që synojnë përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi. Në fushën e punësimit, LMD ka ngarkuar Këshillin e Ministrave, Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrin e Brendshëm për marrjen e masave pozitive, ndërsa në fushën e arsimit, Këshillin e Ministrave dhe Ministrin e Arsimit.

Deri më sot, asnjë nga institucionet e lartpërmendura nuk ka marrë masa pozitive në fushat përkatëse. Mungesa e një veprimtarie të vazhdueshme, nga ana e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për monitorimin e zbatimit të ligjit, ka ndikuar në mënyrë të tërthortë në këtë neglizhencë të institucioneve përgjegjëse. KShH vlerëson se roli i KMD-së dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile të angazhuar në luftën kundër diskriminimit është i rëndësishëm për të “ushtruar presionin e nevojshëm”, në mënyrë që institucionet përgjegjëse të fillojnë nga puna për marrjen e masave pozitive. Kryerja e studimeve gjithëpërfshirëse mbi çështjet e diskriminimit në punësim, arsim dhe sektorin e shërbimeve në Shqipëri, do të ndihmonte këto institucione në përcaktimin e masave pozitive përkatëse.

### 4. Ankesat

Neni 32, pika 1, gërma “a”, “b”, “c” dhe “ç” të LMD, parashikon kompetenca të rëndësishme të KMD-së në drejtim të shqyrtimit të ankesave të ardhura nga personat, ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, si dhe nga OJF-të që kanë një interes të ligjshëm, e që kanë marrë pëlqimin e individit/grupit të individëve të diskriminuar. Për këtë qëllim KMD ka kompetencën për të kryer hetime administrative dhe për të vendosur sanksione, sipas ligjit, kur vlerëson se diskriminimi ka ndodhur realisht.

#### 4.1 Statistika

KMD ende nuk disponon një sistem elektronik për përpunimin e të dhënave (database) që rezultojnë nga ankesat që ka marrë dhe shqyrtuar. Të dhënat lidhur me ankesat janë përpunuar në mënyrë manuale dhe kjo vështirëson kryerjen e analizave të sakta dhe gjithëpërfshirëse.

Që nga momenti i ngritjes së këtij institucioni, KMD ka marrë 19 ankesa, prej të cilave 4 janë të vitit 2010. Ankuesit kane përdorur të gjitha mënyrat e parashikuara në LMD për dërgimin e ankesave para Komisionerit. Ata kanë pretenduar se janë diskriminuar



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

kryesisht në fushën e të mirave dhe shërbimeve<sup>4</sup>, punësimit, arsimimit, në të drejtën e pronësisë, dinjitetin personal etj. Shkaqet për të cilat është pretenduar diskriminimi kanë qenë kryesisht orientimi seksual, gjinia, origjina etnike rome, mosha dhe aftësia e kufizuar. KMD është shprehur me vendim për 8 nga ankesat që ka marrë.

Vetëm në një rast KMD ka konstatuar diskriminim për shkak të orientimit seksual, në kuadër të një ankese të paraqitur nga dy OJF, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në mbrojtje të personave me orientim seksual të ndryshëm. Kjo kërkesë pretendonte diskriminim të kryer nga Zëvendëskryetari i Komisionit Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, gjatë ushtrimit të funksionit të tij. KMD në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese ka vendosur të rekomandojë evitimin e deklaratave me nota diskriminuese ndaj komunitetit LGBT në Shqipëri, si dhe ofrimin e mbështetjes institucionale për të ndihmuar këtë komunitet të gëzojë normalisht të drejtat dhe liritë e tyre. Neni 33, pika 10 dhe 11 i LMD parashikon se “Vendimi i KMD-së përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit”. E drejta e KMD-së për të bërë rekomandime, është një kompetencë e përgjithshme, e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “f”. Megjithatë KShH është e mendimit që për rastet kur KMD konstaton se ndaj personit, ose grupit të personave ankimes ka patur akte diskriminuese, do të ishte mirë të urdhërohej bërja e rregullimeve dhe caktimi i masave të detyrueshme për personin që ka kryer diskriminim, me qëllim rivendosjen e të drejtës që i është shkelur individit ose grupit të individëve nga diskriminimi.

Për sa i takon 7 rasteve të tjera, KMD ka vendosur mospranimin e ankesës, me motivacione të tilla si: diskriminimi është pretenduar para miratimit të ligjit; mungonte dokumentacioni nga përfaqësuesi ligjor i OJF-së; çështja po ndiqej në kuadër të një ankese tjetër, e cila po shqyrtohej në rrugë gjyqësore; mungesa e informacionit të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; etj.

Neni 33, pika 1 dhe 2 e LMD parashikon të drejtën e organizatës me interesa legjitim të paraqesë ankesë në emër të një personi apo grupi personash të diskriminuar si dhe të drejtën e kësaj organizate për të përfaqësuar me prokurë të posaçme, personin ose grupin e personave në procedurat e shqyrtimit të ankesës nga KMD. Dy OJF me interes legjitim kanë investuar bashkarisht KMD në dy raste, duke i përcjellë ankesa për diskriminim për shkak të orientimit seksual. Një nga ankesat është ende në proces shqyrtimi ndërsa në rastin tjetër KMD përfunduar shqyrtimin dhe ka konstatuar diskriminim, duke u shprehur në favor të pretendimeve të OJF-ve (*shih më sipër*). KMD ka përcaktuar dokumentacionin që një OJF duhet të paraqesë për t’u legjitimuar si përfaqësuese e ankuesit/ankuesve:

- a) Kopjen e vendimit për regjistrimin e OJF-së në gjykatë;
- b) Kopjen e aktit të themelimit & Statutit
- c) Prokura e posaçme;

Në përgjithësi Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi është vlerësuar si një ligj i kompletuar dhe në përputhje me legjislacionin e BE-së. Praktika e pakët e zbatimit të tij nuk jep shumë mundësi për të bërë vlerësime të mëtejshme. Megjithatë në lidhje me rastet kur ankesa nuk

<sup>4</sup> Sigurimet shoqërore, kriteret vlerësuese të tenderave, mosshfrytëzimi i fondeve të një OJF-je për strehim, etj.



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

pranohet për shkak të mungesës së informacionit të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim objektiv dhe të drejtë<sup>5</sup>, dëshirojmë të vëmë në dukje se dispozita përkatëse është deri në një farë mase e paqartë dhe për këtë arsye do të ishte e nevojshme që KMD të bëjë një interpretim të kësaj norme me vendimet e saj. Gjithashtu, kalimi i barrës së provës nga ankuesi tek personi kundër të cilit paraqitet ankesa, duket se është ometuar, sepse nuk është parashikuar shprehimisht në dispozitat e LMD-së për procedurat e shqyrtimit të ankesës nga KMD, sipas standardit evropian.

### 4.2 *Investimi ex officio i KMD-së*

Neni 32, pika 1, gërma “c” e LMD parashikon kompetencën e KMD-së për të kryer hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji. Në periudhën që ky raport mbulon KMD është investuar *ex officio* në dy raste.

**Rasti i parë** është për incidentin e datës 20 Shkurt 2010, ku 45 familje Rome janë detyruar që të shpërngulen nga vendbanimet e tyre në fushën pranë Stacionit të trenit në Tiranë, duke i kërcënuar se do t'u vënë zjarrin barakave ku ata jetonin. Për trajtimin e këtij rasti KMD ka marrë pjesë në grupin e punës së ngritur në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. KMD i ka kërkuar informacion Drejtorisë së Policisë së Tiranës, për këtë ngjarje, si dhe ka zhvilluar takim me Drejtorin Ekzekutiv të një OJF-je rome. Më pas, çështja u mbyll për shkak se përfaqësuesi ligjor i OJF-së rome hoqi dorë nga shqyrtimi i çështjes.

**Rasti i dytë** ka të bëjë me segregacionin e fëmijëve romë në shkolla. KMD ka nisur hetimet *ex officio* për këtë rast, ku sipas informacionit të dhënë rezulton se disa fëmijë romë, të regjistruar në klasën e parë për vitin shkollor 2011-2012 në shkollën "Bajram Curri" në Tiranë, dyshohet se janë diskriminuar, për shkak se janë zhvendosur nga klasat fillestare ku ishin regjistruar, në një klasë të vetme. Kjo çështje është ende në proces shqyrtimi nga KMD.

Bazuar në sa më sipër, KShH vëren se numri i rasteve dhe i ankesave të paraqitura KMD-së gjatë periudhës së funksionimit të tij është i ulët.

### 4.3 *Procedura e brendshme e shqyrtimit të ankesave dhe respektimi i afateve*

Procedura e brendshme e marrjes dhe shqyrtimit të ankesave nga KMD kalon në disa faza. Fillimisht ankesat merren nga specialisti përkatës i Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun. Ky sektor është përgjegjës për mbajtjen dhe administrimin e regjistrit për dokumentimin e të gjitha ankesave të drejtuara Zyrës së KMD-së. Në këtë fazë verifikohet dhe zbatimi i kërkesave të aspektit formal të ankesës, sipas parashikimeve të LMD-së. Nëse ankesa i plotëson këto aspekte, ajo i kalohet Drejtorisë së Çështjeve Procedurale, Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, e cila shqyrton nëse informacioni i pasqyruar në ankesë është i mjaftueshëm, me qëllim që KMD të shprehet me vendim, apo të vazhdojë me një hetim të mëtejshëm për zgjidhjen e saj. Nëse është e nevojshme të kryhen hetime të mëtejshme, ankesa kalon në Drejtorinë e Hetim-Inspektimit, e cila ndër të tjera ka si objekt të

<sup>5</sup> Për më shumë shih nenin 33/4/ç të LMD





## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

veprimtarisë së saj kryerjen e inspektimeve dhe te hetimeve per verifikimin e fakteve te paraqitura nga subjektet sipas kërkesave të LMD. Pasi janë ezauruar këto tre faza, është kompetencë e Komisioneres të vendosë pranimin ose jo të ankesës dhe urdhërimin e masave në përputhje me ligjin përkatës. KMD administron dy regjistra, ku evidentohen të dhënat e ankesave; një për ankesat që nuk përmbushin kriteret formale të parashikuara në LMD dhe tjetra për ato që i përmbushin.

Neni 33, pika 10 e LMD parashikon se ‘Komisioneri shprehet me vendim, i cili u njoftohet palëve brenda 90 ditëve nga dita e marrjes së ankesës ose nëse është zhvilluar një seancë dëgjimore publike, brenda 90 ditëve nga dita e seancës. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre’. Nga informacioni që KMD ka përcjellë për ankesat, rezulton që afati i parashikuar në dispozitën e mësipërme është shkelur vetëm për një ankesë të paraqitur kundër Zëvendëskryetarit në detyrë të Komisionit Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Arsyeja e shkeljes së afatit është vështirësia që KMD ka patur për akses në informacion nga pala kundrejt të cilës është paraqitur ankesa.

Ky rast nxori në evidencë edhe një mangësi të LMD, i cili parashikon që KMD duhe të shprehet me vendim brenda 90 ditëve nga dita e seancës por nuk përcakton afatin nga momenti i marrjes së ankesës deri në ditën që zhvillohet seanca dëgjimore publike. Për këtë arsye, kjo pjesë e dispozitës lë shteg për shkaktimin e zvarritjeve në shqyrtimin e ankesave në kuadër të të cilave është zhvilluar një seancë dëgjimore publike. Sugjerojmë, që KMD mund të nxjerrë akte të brendshme normative për të mbuluar këtë boshllëk legjislativ.

### **5. Përfaqësimi i ankuesve në organet gjyqësore/Parashtrimi i mendimeve me shkrim në gjykatë**

LMD parashikon dy kompetenca të rëndësishme për KMD në raport me organet gjyqësore me qëllim që të garantohet më mirë shqyrtimi i specializuar i rasteve të diskriminimit në gjykata. Neni 31, pika 1, gërma “i” e LMD parashikon kompetencën e KMD-së për të përfaqësuar ankuesin në organet gjyqësore në çështje civile, me miratimin e të dëmtuarit dhe në përputhje me procedurën e parashikuar në këtë ligj. Neni 31, pika 1, gërma “gj” e LMD parashikon të drejtën e KMD-së që, me kërkesë të gjykatës që shqyrton çështjen, të parashtrijë mendim me shkrim për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin.

Për sa më sipër, KShH konstatoi se asnjë nga dispozitat e mësipërme nuk ka gjetur zbatim gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga KMD, deri tani. Për më tepër, asnjë individ/grup individësh nuk ka ezauruar specifikisht mjetin juridik të kërkesë padisë para gjykatës për çështje diskriminimi, bazuar në LMD.

KShH mendon se aksesit i qytetarëve të diskriminuar në organet e drejtësisë është kufizuar nga urdhëri i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, nr.991/3, datë 03/02/2010, i cili ka katërfishuar tarifat e kërkesë padive dhe të përçindjes që i parapaguhet gjykatës për dëmin që paditësi kërkon t’i jepet si dëmshpërblim. Lidhur me këtë dëshirojmë të vëre në dukje se ndër grupet më të diskriminuara në Shqipëri, janë personat që kanë të ardhura shumë të ulëta financiare. Natyra e çështjeve të diskriminimit



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

është e lidhur me shkaktimin e dëmit, i cili mund të jetë pasuror dhe/ose jo pasuror, prandaj tarifat e sipërcituara pengojnë këto kategori personash t'i drejtohen gjykatës. Përveç kësaj, aksesit i qytetarëve është i ulët edhe për shkak të mungesës së besimit ndaj organeve të drejtësisë, ç'ka shkaktohet kryesisht nga zvarritjet e çështjeve prej gjykatave e prokurorëve dhe vlerësimit për korrupsion qe publiku ka për këto organe<sup>6</sup>.

Lidhur me të drejtën e KMD-së për të përfaqësuar ankuesin e diskriminuar në organet gjyqësore, për çështje civile, KShH sugjeron që të kryhet sensibilizim më i mirë i qytetarëve për këtë kompetencë të KMD-së. Përcaktimi i kriterëve të qarta, në aktet e brendshme të KMD, se kur dhe në ç'kushte ky institucion mund të përfaqësojë ankuesin në organet gjyqësore, përbën garanci për realizimin e kësaj të drejte në praktikë.

### 6. Monitorimi i zbatimit të ligjit/ Kryerja e sondazheve

Përkatësisht neni 31, pika 1, gërma “dh” dhe gërma “e” e LMD parashikon kompetencën e KMD për të monitoruar zbatimin e ligjit dhe për të kryer sondazhe lidhur me çështjet e diskriminimit. Në periudhën që ky raport mbulon, KMD ende nuk ka zbatuar asnjë nga këto kompetenca. Ndër faktorët kryesorë kanë qenë pamjaftueshmëria e burimeve financiare dhe fakti që institucioni është relativisht i ri dhe ende nuk ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e tyre. Është pozitiv fakti se në buxhetin e vitit 2012 që i është akorduar KMD-së, është parashikuar realizimi i një monitorimi për zbatimin e LMD-së dhe i një studimi për çështjet e diskriminimit.

### 7. Nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit nëpërmjet organizimit të aktiviteteve informuese/sensibilizuese<sup>7</sup>

Ndërgjegjësimi dhe edukimi ligjor i qytetarëve për LMD është shumë i rëndësishëm për të mundësuar zbatimin e tij. Veçanërisht, grupet vulnerabël si gratë, fëmijët, romët, egjiptianët, personat LGBT etj, duhet të njihen me përmbajtjen e këtij ligji për arsye se këto kategori janë përkufizuar si ndër më të diskriminuarat në raporte të ndryshme për të drejtat e njeriut, të prezantuara nga organizatat vendase dhe ato ndërkombëtare.

Neni 32, pika 1, gërma “d” e LPD, parashikon se KMD, ka si kompetencë *“të nxisë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuar”*.

Lidhur me sa më sipër, KMD ka përgatitur dhe publikuar broshura dhe materiale sensibilizuese, të cilat përmbajnë informacion për zyrën e KMD dhe përmbajtjen e LMD, formularin e ankesës që plotësohet nga qytetarët që pretendojnë se janë diskriminuar etj. Gjithashtu, është mundësuar përkthimi i ligjit në disa gjuhë minoritare, si dhe është bërë përshtatja për t'u lexuar nga personat me aftësi të kufizuar në shqisën e shikimit.

<sup>6</sup> Ky përfundim bazohet në reagimet e qytetarëve që sjellin ankesa në kuadër të programit “Klinika Ligjore Falas” që vepron në KShH dhe konkuzione të raporteve vlerësuese të BE dhe Departamentit të Shtetit mbi Shqipërinë .

<sup>7</sup> Përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuar



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Gjithashtu, formati i ankesës që paraqitet në KMD-së është përkthyer në 2-3 gjuhë minoritare. KMD po bashkëpunon me strukturat e policisë për finalizimin e përbajtjes së posterave, që tregojnë rreth LMD, të cilët do të vendosen në ambientet e policisë. Në bashkëpunim me PNUD, KMD ka zhvilluar një cikël trajnimesh, në disa qarqe të vendit, me qëllim informimin e pushtetit lokal me përbajtjen e LMD-së si dhe funksionimin e zyrës së KMD-së.

KMD ka zhvilluar disa aktivitete sporadike ndërgjegjësuere të tilla si: pjesëmarrje në debate televizive, prezenca në mediane dhe shkruar, organizimi i një tryeze të rrumbullakët në bashkëpunim me OSBE-në, në të cilën u ekspozuan punime artistike të nxënësve të 6 shkollave të qytetit të Tiranës për çështjet e diskriminimit etj.

Vepimtari ndërgjegjësuere rreth LMD kanë zhvilluar edhe një sërë ofj, megjithatë KShH vërejt se aktiviteti i KMD në kuadër të ndërgjegjësimit dhe edukimit të qytetarëve për LMD, ndonëse i gjerë, nuk ka qenë i mjaftueshëm. Mungesa e fondeve të nevojshme është një ndër arsytet e përfshirjes së ulët të KMD-së në këto aktivitete. KShH vlerëson se krijimi i besimit të publikut për institucionin e KMD-së, është një ndër faktorët kryesorë për shtimin e ankesave për të kërkuar mbrojtje nga diskriminimi, ç'ka do të bënte realitet edhe qëllimin kryesor të këtij ligji.

## **8. Bashkëpunimi institucional**

Gjatë periudhës që ky raport mbulon, KMD ka vendosur kontakte me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të mundësuar marrjen e të dhënave rreth OJF-të që veprojnë në Shqipëri, të cilat kanë në fokus të punës së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kryesisht mbrojtjen nga çdo lloj diskriminimi. Marrëdhënie bashkëpunimi janë vendosur edhe me institucione të tjera shtetërore si: Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Integritit, organet e pushtetit vendor, etj. Me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është në proces finalizimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit. Komisioni i Ndhmës Juridike dhe KMD kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi i cili parashikon aktivitete të përbashkëta sensibilizuese midis dy institucioneve, krijimin e lehtësive për realizimin e monitorimit të zbatimit të LMD, ofrimin e avokatit falas për ndjekjen e çështjeve civile me objekt diskriminimin dhe trajnimin e avokatëve të Komisionit për Ndhmën Juridike nga KMD në këtë fushë. KShH është e mendimit se KMD duhet të zgjerojë bashkëpunimin edhe me Avokatin e Popullit dhe pushtetin vendor.

## **9. Zhvillimi i dialogut të rregullt me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë OJF-të;**

Neni 32, pika 1, gërma “k” e LMD parashikon kompetencën e KMD-së për “zhvillimin e dialogut të rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë OJF-të”. KMD ka patur bashkëpunim shumë të mirë me organizata të vendit dhe ato ndërkombëtare si: Zyra e OSBE-së në Shqipëri, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur në Shqipëri, UNICEF, Pink Embassy, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, TLAS, QNLQ, Këshilli Britanik, Këshilli i Evropës etj. Bashkëpunimi ka konsistuar në pjesëmarrjen e KMD-së në aktivitetet e zhvilluara nga këto organizata, të cilat kanë patur në fokus çështjet e





# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

diskriminimit, të tilla si: konferenca kombëtare dhe rajonale, tryeza pune dhe dialogu, trajnime, seminare, debate kombëtare, etj. Midis KMD-së dhe KShH-së është nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi.

KShH vlerëson aktivitetin e deritanishëm të KMD-së për sa i takon zhvillimit të dialogut të rregullt me organizatat vendase dhe ndërkombëtare, që veprojnë në Shqipëri. Mgjith, KShH dëshiron të vërë në dukje faktin se ky bashkëpunim, në të gjitha rastet, është iniciuar nga shoqëria civile në kuadër të aktiviteteve të ndryshme që janë realizuar me nismë të saj. Gjithashtu, KMD nuk ka ndërmarrë nisma për zhvillimin e dialogut të rregullt me grupet sociale.

## Rekomandime

- KShH sugjeron që në të ardhmen të studiohet mundësia për bërjen e amendimeve të nevojshme në LMD dhe aktet nënligjore lidhur me aspekte të ndryshme që kanë nevojë për përmirësim, si psh lidhur me qartësimin e barrës së provës në procesin civil për mbrojtjen nga diskriminimi; qartësimin e kushteve dhe rrethanave për ta konsideruar nëse një ankese i mungon informacioni i besueshëm për të mundësuar kryerjen e një hetimi; për të saktësuar afatet e fillimit të shqyrtimit të një ankese nga KMD, para zhvillimit të një seancë dëgjimore publike, etj.
- Sugjerojmë që KMD të nxitë organet përgjegjëse, që në zbatim të ligjit, të marrin masa pozitive të nevojshme, në kuadër të mbrojtjes nga diskriminimi.
- KShH sugjeron që KMD të jetë më aktiv dhe të rrisë numrin e hetimeve administrative ex officio, veçanërisht për rastet e diskriminimit që bëhen publike nga media e shkruar dhe elektronike, të atyre që evidentohen në raportet që prezantojnë organizatat vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
- Për sa i takon procedurës së brendshme të marrjes dhe shqyrtimit të ankesave, KShH sugjeron që KMD të bëjë, herë pas here, rivlerësimin e procedurës dhe strukturës së brendshme organizative, që lidhet me trajtimin e ankesave, me qëllim që duke analizuar eksperiencën e shqyrtimit të rasteve, që merr për trajtim, të krijojë kushte gjithnjë e më të përshtatshme për të thithur ankese dhe për t'i shqyrtuar shpejt dhe sa më drejtë ato.
- KShH i sugjeron Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë që të rishikojnë edhe një herë urdhërin Nr. nr.991/3, datë 03/02/2010 për tarifën që paguhet për angazhimin e gjykatave në shqyrtimin e çështjeve civile, sidomos për personat të cilët janë viktimat të diskriminimit dhe kategori të ngjashme, me qëllim për t'i përjashtuar nga detyrimi për pagimin e tarifës. Gjithashtu sugjerojmë që dhe KMD të bëjë lobimin e saj në këtë aspekt.
- KShH, sugjeron që KMD të rrisë bashkëpunimin me organizatat vendase dhe ndërkombëtare, institucione të brendshme, që merren me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore si dhe të marrë eksperiencë nga institucionet homologe në vendet e zhvilluara, për të realizuar veprimtari monitoruese/sondazhe, me qëllim evidentimin e gjendjes fenomenit të diskriminimit në Shqipëri.



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- 
- KShH i sugjeron KMD-së të rrisë aktivitetet ndërgjegjësuere dhe informuese me qëllim rritjen e aksesit të qytetarëve pranë atij Institucioni.
  - KShH beson dhe sugjeron në vazhdimësinë e bashkëpunimit të KMD-së me aktorë të shoqërisë civile që kanë në fokusin e tyre edukimin ligjor të qytetarëve, duke zhvilluar aktivitete të përbashkëta me karakter ndërgjegjësuere dhe edukativ, ashtu si dhe në përgatitjen e studimeve të përbashkëta, ngritjen e kapaciteteve të stafëve si dhe për referimin e rasteve të diskriminimit pranë institucioneve përkatëse.
  - KShH i sugjeron KMD-së zhvillimin në vazhdimësi të aktiviteteve të tilla si: tryeza pune apo takime me grupet e interesit<sup>8</sup>, në mënyrë që të diskutohen format e diskriminimit me të cilat përballen këto grupe, adresimin e tyre në rrugë institucionale si dhe të shikohet mundësia e përfshirjes së grupeve të interesit në aktivitete të përbashkëta me KMD-në me karakter informues/sensibilizues dhe trajnues etj.

---

<sup>8</sup> Të cilat përfaqësojnë shtresat më të diskriminuara të shoqërisë shqiptare